

PIRAMIDA DHE QYTETI I NDALUAR

Në Tiranë ka një piramidë. Në kuptimin e fjalëpërfjalshëm. Dhe goxha e lartë. Është një ndërtesë moderniste prej mermeri të bardhë, shfaqur nga gjysma e dytë e viteve '80, për të qenë muzeumi i Enver Hoxhës, i diktatorit të sapovdekur.

Por kjo nuk vazhdoi gjatë. Pak vite më vonë, regjimi u shemb dhe, bashkë me të, edhe kulti i diktatorit të vdekur. Asokohe, në valën e protestave, një turmë demonstruesish duke kaluar atypari, e përballur me një barrierë forcash speciale dhe tankesh, bërtiste: “Piramida, diskotekë!” Dhe u bë, ndër të tjera, edhe diskotekë (Vox populi, vox Dei). Zyrtarisht quhet “Qendra Ndërkombëtare e Kulturës”. Por në adresën postare duhet shënuar “Piramida”. Përmban një sërë institucionesh. Aty kanë qenë fillimisht, fill mbas ndryshimeve, Komiteti Shqiptar i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe një nga degët e Fondacionit të George Soros-it për Shoqërinë e Hapur, pastaj edhe një agjenci publicitare, dhe më pas u vendosën aty zyrat e USIA-s, Biblioteka e British Council (e quajtur “Biblioteka Lady D.”), si dhe Top Chanel, kanali televiziv më i madh i vendit. Në një mjedis të katit të nëndheshëm ndodhet “Bar Mumia”. Në mot të ngrohtë, “Mumia” del s’andejmi për të pushtuar me tryeza e karrige një pjesë të sheshit rrotull Piramidës. Përbri, shtrihet bulevardi i madh i Tiranës, i krahasueshëm nga përmasat me Avenue des Champs Elysées, i ndërtuar nga pushtuesit italianë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Aq i madh sa, më 1945, një shkrimtar sovjetik i ardhur në Tiranë tha se kishte vizituar sa e sa qytete pa bulevard, po për herë të parë po shihte një bulevard pa qytet.

Sidoqoftë, nga tryezat rrotull Piramidës, duke pirë një kafe apo një gotë, mund të shohësh, matanë bulevardit, ish-Komitetin Qendror të Partisë, aktualisht seli e disa institucioneve të reja, si për shembull Komiteti i ish-të Përndjekurve Politikë (mijëra të burgosur dhe dhjetramijëra të internuar në saje të pushtetit që ushtrohej në po këtë ndërtesë). Midis ish-Komitetit Qendror dhe Kullave Binjake, siç quhen dy rrokaqiej të xhamtë ngritur vitet e fundit, duken në sfond çatitë e dhe katet e sipërme të disa prej godinave të Bllokut...